





01-1479

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-149745/20 dt. 24.08.2020, të pronareve Hasim Begolli nga Prishtina, dhe investitorit ”Pozhego Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “B10”, të Planit Rregullues “Kalabria”, në rr. “Rexhep Krasniqi”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 10.06.2021, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. I LEJOHET** Hasim Begolli nga Prishtina, dhe investitorit ”Pozhego Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-149745/20 dt. 24.08.2020, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës “B10/A1” me etazhitet 2B+P+8 e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 11.04.2017, në parcelën kadastrale nr. 10212-0 (produkt i bashkimit të parces kadastrale me nr. 10080-3 dhe parces kadastrale me nr. 10080-5), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10212-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik “B10”, të Planit Rregullues “Kalabria” në Prishtinë.
- II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Rexhep Krasniqi” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 161, 163, 163/1, 163/2, 163/3, 163/4, në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.
- VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronareve Hasim Begolli nga Prishtina, me investitor ”Pozhego Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-149745/20 dt. 24.08.2020, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, përkatësisht ndërtesës “B10/A1” me etazhitet 2B+P+8 e ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “B10”, të Planit Rregullues “Kalabria”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10212-0 (produkt i bashkimit të parces kadastrale me nr. 10080-3 dhe parces kadastrale me nr. 10080-5), ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 11.04.2017, Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të lejes ndërtimore 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 11.04.2017, Vendimi 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 25.09.2017, Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të lejes ndërtimore 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 11.04.2017, Vendimi 05 Nr.

Faqe 1 prej 3

351/02-11539/17 dt. 03.07.2018, Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit – projektit kryesor 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 11.04.2017, Vendimi 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 28.06.2019, Vendimit të Korigjimit të gabimit teknik të vendimit 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 11.04.2017 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të lejes ndërtimore 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 11.04.2017, për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm – “B10/A1” me 2B+P+8, Vendimi 05 Nr. 351/02-11539/17 dt. 22.10.2020, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-72122/19 dt. 18.01.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 6 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Krenare Kadriu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Rexhep Saliu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Violeta Hoxha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Asmir Hamdi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Korab Lushta; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Burim Halilaj me nr. të licensës 195;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.



**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-149745/20 DT. 10.06.2021**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi

Drejtori,
Ardian Olluri



